



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 3 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i njohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e73-të, të mbajtur më 18.08.2022, morri vendimin vijues:

### VENDIM

Veprimi ndaj lëndës me numër 12-916/1 datë 25.02.2021, NDËRPRITET KSHPK vërtetoi se lënda nuk ka elemente për veprimin e saj kompetent në pajtim me Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit.

Deri te Agjencia për Mbështetjen e Sipërmarrësisë së RMV-së të dorëzohet rekomandim, për të shqyrtuar mundësinë e dorëzimit elektronik të aplikacioneve pas thirrjeve të shpallura publike për zbatimin e projekteve në mbështetje të zhvillimit të ekonomisë së vogël dhe nxitjes së sipërmarrjes në RMV.

Lënda me numër 12-916 të vitit 2021 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

### Arsyetim

Lënda me numër 12-916/1 të datës 25.02.2021 është formuar në bazë të denoncimit të marrë nga ///. Pretendimet e paraqitura në denoncim kanë të bëjnë me dyshime për veprime jo të duhura dhe keqpërdorim të detyrës zyrtare të personave zyrtarë në ///, për shkak të refuzimit të pabazë të kërkesës së paraqitur për pjesëmarrje në trajnim të një sipërmarrësi të papunë - parashtruesi. Siç është theksuar në denoncim, parashtruesi e ka dorëzuar Lutjen në vitin ///nëpërmjet postës, ndërsa të njëjtën Agjencia e ka pranuar në vitin ///, ku nuk është mbajtur evidencë se parashtruesat konsiderohen të pranuar në ditën e dorëzimit të tyre në poste nga KSHPK-ja kërkohet ta rishqyrtojë këtë rast në përputhje me kompetencat e saj ligjore. Në shtojcë të denoncimit, nuk u dorëzuan prova.

Pas mbikëqyrjes së përmbajtjes së denoncimit, KSHPK-ja kërkoi trajtimin e duhur nga Agjencia dhe rregullimin e kërkesës nga parashtrues dhe nga dhënat, informacionet dhe dokumentacionet e refuzuar, vlerësoi se refuzimi i kërkesës së parashtruesit ishte produkt i dobësisë sistematike. Lënda e shpalljes me nr. /// ishte shpallur në bazë të nenit. 22 të Ligjit për krijimin e Agjencisë së Mbështetjes së Sipërmarrjes të RMV-së ("Gazeta Zyrtare e RM-së" Nr.

60/03 ... 64/18), me pikën.1 të këtij neni thotë se Agjencia i zbaton projektet për të mbështetjen e zhvillimit të sipërmarrjeve të vogëla dhe inkurajimin e sipërmarrjen me thirrje publike. Prandaj, është e drejtë e Agjencisë që të rregullojë si mënyrën ashtu edhe afatin e dorëzimit të aplikimeve për pjesëmarrësit e interesuar në thirrjen publike, që do të thotë se Nen. 46 të Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare RM-së nr. 124/15) është i pa aplikueshëm për rastin konkret. Megjithatë, për të siguruar një orientim më të madh shërbimi të Agjencisë ndaj sipërmarrësve, KSHPK-ja vlerëson se është e nevojshme që Agjencia të shqyrtojë mundësinë e dorëzimit elektronik të aplikimeve të pjesëmarrësve të interesuar në të ardhmen, për këtë arsye vendosi të dërgojë një rekomandim për Agjencinë që të shqyrtojë një mundësi të tillë nga ana e saj.

Sipas sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

Dorëzuar deri te:  
Parashtruesi i denoncimit  
Agjencia për Mbështetjen e Sipërmarrësisë së RMV-së

Përgaditi: Mr D. D.  
Miratuar: Mr V.G.

KOMISIONI SHTETËRORE  
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT  
KRYETARE,  
Biljana Ivanovska